



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Datë 09.09.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit: "PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2025-2028, TË BASHKISË Durrës.*

Baza ligjore:

Ligji nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjin nr. 47/2018, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligjin 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligjin 22/2018, "Për strehimin social", Ligjin 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" dhe Ligjin 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e Planit Social 2025-2028 të Bashkisë Durrës sipas draftit bashkëlidhur.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Natyra e financimit është me buxhetin e bashkisë Durrës, qeveria qëndrore dhe donatorë.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimit Social.

Impakti social/grupet që preken:

Banorë e bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

Po. Konsultimi është zhvilluar konform kuadrit ligjor, online përgjatë muajit korrik-gusht ku dokumentacioni është hedhur në faqen web të bashkisë Durrës. Të interesuarit i kanë paraqitur sugjerimet e tyre në adresat e emailit të bëra publike në njoftimin për konsultim.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mbledhë më datë 09.09.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 2 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Kryetar Edlira Shemsi

Zv/Kryetar Florian Tahiri

Sekretar Bledar Prizreni

Anëtar Xhiliola Doçi

Anëtar Denis Lika

[Signatures]
PRO
[Signatures]
PRO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Datë 09.09.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit MIRATIMIN E FAMILJEVE PËR FITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN GUSHT 2025.*

Baza ligjore:

Ligji nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Ligji nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025”; Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.1, datë 11.02.2025 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato, që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 134 (njëqind e tridhjetë e katër) familje me një fond prej 585.871 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë.

Nr	NJËSITË ADMINISTRATIVE	Nr	Lekë
1	Njesitë Administrative Durrës	87	386.659
2	Njësia Administrative Rrashbull	14	60.006
3	Njësia Administrative Sukth	25	103.776

4	Njësia Administrative Ishëm	1	8520
5	Njësia Administrative Katund i Ri	5	19.980
6	Njësia Administrative Manëz	2	6.930
	Shuma	134	585.871

2. Familjet që përfitojnë në skemën e Ndhmës Ekonomike, nga të ardhurat e Bashkisë ndodhen në listën bashkëngjitur materialit.
3. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej -3- familje nga fondi i Bashkisë.
4. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Gusht 2025 të 5 (pesë) familjeve, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës.
5. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi 6 % i fondit të kushtëzuar 37 (tridhjetë e shtatë) / familje me një fond 184.782 (njëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Natyra e financimit është me të ardhurat e veta të bashkisë Durrës dhe nga fondi i kushtëzuar 6% për bllok ndihmën ekonomike.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimit Social.

Impakti social/grupet që preken:

Familjet të cilat jetojnë në territorin e bashkisë Durrës, të cilat përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6% dhe ato që janë në kushte të vështira ekonomike dhe që përfitojnë nga të ardhurat e bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mbledhë më datë 09.09.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 5 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Kryetar

Edlira Shemsi



Zv/Kryetar

Florian Tahiri


 PRO

Sekretar

Bledar Prizreni

Anëtar

Xhiliola Doçi

 PRO

Anëtar

Denis Lika

 PRO